



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 18. 3. 2015, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Puhie Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Me ftesë të Komisionit, në mbledhje ishte prezent ministrja për Dialog, znj. Edita Tahiri dhe Dren Zeka, këshilltar i lartë politik.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK, Gurjeta Zeka-VV dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20 shkurt 2015;
4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës;
5. Njoftim rreth bashkëpunimit parlamentar;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20 shkurt 2015

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20 shkurt 2015.

3. Raportim i ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri

Enver Hoxhaj, falënderoi ministren Edita Tahiri për gatishmërinë për të marrë pjesë në Komision, si dhe për punën që është duke bërë. Lidhur me këtë raportim, kërkoi të informohet nga ministrja rreth implementimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani, se çka do të ndodhë me dialogun gjatë viteve të ardhshme dhe cilat tema do të jenë pjesë e dialogut në të ardhmen, për të cilat tha se do të duhej të ishin të karakterit bilateral. Ai kërkoi të informohet lidhur me angazhimet për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare kyçe evropiane, po ashtu theksoi rëndësinë e anëtarësimit të Kuvendit në organizata parlamentare.

Edita Tahiri, tha se çështja e dialogut të Brukselit është një prej prioritetëve të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Dialogu nuk ka qenë i preferuar nga qytetarët tanë, meqë ka munguar falja për gjithë tragjedinë dhe gjenocidin e bërë nga ana e Serbisë. Gjatë këtyre katër viteve të dialogut, përmendi rezultatet e para të arritura, që kanë mundur forcimin e sovranitetit të shtetit të Kosovës nga brenda, përmes arritjes së disa marrëveshjeve. Fillimisht, me marrëveshjen e IBM-së, Kosova ka rumbullakuar procesin e vendosjes së kufijve. Në kuadër të marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, është normalizuar lëvizja e lirë sipas parimeve të BE-së dhe parimeve të reciprocitetit në mes të dy shteteve, e ngjashëm ka ndodhur edhe me marrëveshjen për tregtinë e lirë, e cila ka vendosur parimet e tregtisë së lirë, por edhe parimet e reciprocitetit në këtë proces. Ajo njoftoi edhe për zhvillimet, në sajë të marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve, të ndërmjetësuar nga BE, në sajë të së cilës, 4 komunat veriore, për herë të parë morën pjesë në zgjedhjet lokale të shtetit të Kosovës. Përmes kësaj marrëveshjeje, janë shuar strukturat ilegale serbe dhe ish- pjesëtarët e kësaj strukture tani janë pjesë e institucioneve të Policisë së Kosovës. Bëri të ditur se po kjo marrëveshje ka vendosur një parim që të dy shtetet të mos e pengojnë njëra- tjetrën në rrugën e integritetit evropian dhe se Serbia nuk mund të bëhet anëtare e BE-së pa e njohur pavarësinë Kosovës. Njoftoi se për një vit e gjysmë, Serbia pengohet nga BE-ja, për të hapur bisedimet për anëtarësim, pikërisht pse ka dështuar në zbatimin e marrëveshjeve, në kuptimin që vazhdon të mbajë strukturat paralele në pjesën veriore të vendit dhe obstrukcionin e saj ndaj komunave të veriut, për të cilat çështje është njoftuar Brukseli.

Në planin e jashtëm, tha se dialogu e ka ndihmuar Kosovën që të përparojë në planin e integritetit evropian dhe ka kontribuar në shpejtimin e Procesit të Stabilizim-Asocimit, dhe se pritet që së shpejti Kosova të nënshkruajë MSA-në. Gjithashtu, njoftoi se i është bërë kërkesë BE-së, që Kosovës sa më parë t'i jepet statusi i kandidatit për anëtarësim në BE. Më tej, tha se në fillim të muajit shkurt, është arritur marrëveshja për zbatimin e çështjeve të drejtësisë, e cila ka hyrë në procesin e implementimit. Theksoi se është në proces shuarja e strukturës paramilitare, heqja e barrikadës mbi lumin Ibër, dhe se më pas mund të hapen diskutimet për asociacionin. Bëri të ditur se asociacioni do të funksionojë në përputhje të plotë me ligjet ekzistuese të Republikës së Kosovës. Ministrja njoftoi se temat e paraqitura zyrtarisht në agjendën e dialogut në të ardhmen janë: demarkacioni shtetëror mes kufirit të Kosovës e Serbisë, respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial mes dy shteteve, mosndërhyrja në sovranitetin e njëra-tjetrës, njohja e ndërsjellë në mes të dy shteteve, vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fushat e interesit të ndërsjellë në mes të dy shteteve, pamundësia që Serbia të bëhet anëtare e BE-së, pa e njohur pavarësinë e Kosovës dhe respektimi i ndërsjellë i standardeve për minoritetet nga të dyja shtetet.

Teuta Rugova, falënderoi ministren për raportimin dhe punën e bërë deri më tani dhe theksoi të nevojshëm bashkëpunimin me Komisionin edhe në të ardhmen.

Puhie Demaku, duke u ndërlidhur me raportimin e ministres, theksoi se ministrja fillimisht tha se kapitulli 35 kushtëzon anëtarësimin e Serbisë në BE, me njohjen e Kosovës, ndërsa kapitulli 35 krijon normalizim e jo pranim. Lidhur me temën e paraqitur për diskutim në Bruksel, për respektimin e sovranitetit e integritetit, deputetja Demaku tha se kjo temë do të duhej të ishte parim mbi të cilin zhvillohet dialogu, e jo temë diskutimi në Bruksel. Në vazhdim, ajo pyeti ministren:

- Pse nuk i është përgjigjur ftesave të ish- kryetarit të komisionit për të raportuar në Komision? Kujt i ka dhënë dhe kujt i jep përgjegjësi për dialogun? A pajtohet me temat e dialogut, të listuara në Programin qeveritar 2015 dhe kush i ka përzgjedhur ato? Cilat janë temat që duhet të trajtohen me prioritet? A ka pasur ndonjë kusht në dialogun e radhës? Lidhur me takimet me Serbinë se a po na thuhet e vërteta neve apo BE-së, a është pala serbe bashkëpunuese apo nuk është? Si mund të pritet që Serbia t'i përmbushë obligimet ndaj Kosovës, meqë gjatë interpelancës keni thënë se nuk duhet pasur pritje të mëdha nga Serbia në përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare? Çfarë është bërë me marrëveshjet për diplomat? A i konsideroni diskriminuese nenet 13 dhe 14 të Marrëveshjes për drejtësi? Më tej, duke cituar një intervistë të gazetës "Express", ajo pyeti: A po cenohet sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës? Lidhur me deklaratat për heqjen e barrikadës, pyeti: A është në dijeni ministrja se barrikada ende qëndron aty, mos është edhe kjo diçka e ngjashme me filluskën e borës? A është përdorur ligji për të zgjidhur këtë çështje? Pse nuk janë shuar strukturat ilegale në veri dhe a është në dijeni për mbajtjen e akademisë përkujtimore për trazirat e marsit 2004, ku kanë marrë pjesë edhe shefat e Policisë së Kosovës në veri? A janë ankuar në Bruksel për vizitat skandaloze të Vuçiqit në Kosovë? A e largoi ndikimin e Beogradit apo e solli Listën Serbe marrëveshja? Lidhur me deklaratën se pa u zgjidhur çështja e drejtësisë dhe shuarja e mbrojtjes civile, nuk mund të bisedohet për asociacionin, pyeti: Si e komenton këtë deklaratë në frymë të realitetit në terren?

Blerta Deliu-Kodra, pyeti për peticionin që është bërë lidhur me gratë e dhunuara gjatë luftës, drejtuar OKB-së për hartimin e një raporti ndërkombëtar, se ku kanë shkuar procedurat lidhur me këtë çështje. Po ashtu, u interesua për çështjen e personave të pagjetur, se sa është arritur të punohet në këtë drejtim dhe cilat do të jenë hapat e mëtejshëm sa i përket dialogut.

Zafir Berisha, shprehu mendimin se ministrja Tahiri ka një nga përgjegjësitë më të mëdha, pas shpalljes së pavarësisë. Sipas tij, bisedimet kanë filluar si bisedime teknike pastaj rezultuan të jenë politike dhe se rezultati i bisedimeve e ka ngulfatur perspektiven evropiane të vendit, për arsye se Serbia është bërë partner në çështjet e brendshme të Kosovës. Më tej, shtoi se me lëshimet e bëra në dialog janë lënë jashtë loje qytetarët luajalë serbë, duke favorizuar një ekstrem nacional, si Listën Serbe, pjesë të institucioneve të Kosovës, të cilët mbajnë në tension situatën në Kosovë. Duke folur për integrimin e strukturave paralele në institucionet e Kosovës, tha se nuk duhet të na çudit fakti që në një të ardhme kjo pjesë mund të jetë një Krime, sepse atje kemi një klasë politike, një forcë të sigurisë, në kuadër të Policisë së Kosovës. Deputeti Berisha shtroi pyetjen: Pse nuk është ngulur këmbë që të trajtohen shqiptarët e Luginës së Preshevës në këto bisedime, meqë atje kemi një presion sistematik shtetëror ndaj shqiptarëve?

Qerim Bajrami, falënderoi ministren për raportimin për dialogun në mes të shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë dhe theksoi se janë të vetëdijshëm se Serbia, marrëveshjet e arritura tenton të mos i zbatojë. Për zbatimin e marrëveshjeve, tha se do të ishte mirë që në bashkëpunim me BE-në të gjendet një mekanizëm i cili do të ndëshkonte palën që nuk do të zbatonte marrëveshjen e arritur, e në këtë rast, Serbinë. Megjithatë, përmes dialogut, tha se Kosova po përfiton drejt procesit të integritetit evropian dhe në shtrirjen e sovranitetit në veri të vendit. Sipas tij, një pjesë e boshnjakëve të cilët jetojnë në veri, nga procesi i dialogut tani ndihen më mirë, edhe pse ende janë kushtet e vështira, duke theksuar vrasjen e qytetarit luajal të Kosovës, Shefko Salković, për të cilin tha se ende nuk është hetuar asgjë. Lidhur me marrëveshjen e fundit të arritur me Serbinë, rreth gjykatave tha se e kemi përshëndetur këtë

hap, por jemi të shqetësuar, ngase në strukturën gjyqësore nuk është paraparë asnjë pjesëtar i komuniteteve të tjera dhe për këtë do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Elmi Reçica, tha se pas lirisë dhe pavarësisë dialogu me Serbinë është detyra më e rëndë dhe kërkon një angazhim të gjithanshëm. Deputeti Reçica shprehu mendimin se kjo çështje duhet të trajtohet si çështje e jashtme, meqë ky është një raport ndërshtetëror dhe se ky Komision, institucionet dhe kapacitetet e vendit, do të duhej të ishin në dispozicion, në mënyrë që të dilet me një rezultat sa më të suksesshëm. Kërkoj që të insistohet sa më shumë në realizimin konkret të marrëveshjeve të arritura, jo vetëm në fushën e sovranitetit, por edhe në atë të telekomunikacionit, të pensioneve e të tjera. Po ashtu, kërkoj që të vazhdohet koordinimi me BE-në, SHBA-të, por edhe me vendet që kanë rezerva në raport me Kosovën.

Edita Tahiri, tha se përgjegjësia për dështimin e administrimit të veriut i takon UNMIK-ut, duke shtuar se është folur për ndarjen e Kosovës, mirëpo sipas ministres Tahiri, sukcesi i parë dhe i madh i këtij dialogu është se e ka hequr nga agenda ndarjen e Kosovës. Dialogu është obligim ndërkombëtar, që rezulton nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme e OKB-së, e vitit 2010, i mbështetur edhe nga Kuvendi i Kosovës. Lidhur me pyetjen se a ka kushtëzime, ministrja tha se BE-ja kushtëzimet ia ka bërë të qarta të dyja shteteve, nëse nuk ka përparime në dialog, nuk ka përparim në integrim evropian, mirëpo ndaj Serbisë ka shtuar kushtëzime, për shkak të moszbatimit të marrëveshjeve të arritura. Kushtëzimi shtesë për Serbinë është kapitulli 35, me të cilin obligohet të normalizojë marrëdhëniet fqinjësore me Kosovën.

Marrëveshja për drejtësi merret me zhbërjen e strukturave ilegale të drejtësisë, nuk përjashtohen minoritetet tjera, por përcakton se do të veprojë një gjykatë themelore dhe një zyrë prokurorie, për shkak të komunave, duke shtuar se këto janë institucione të Republikës së Kosovës.

Lidhur me pyetjet e deputetes Demaku për çështjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, ministrja Tahiri tha se që nga viti 1999, Kosovës i është cenuar sovraniteti në pjesën veriore, por ne kemi zgjedhur alternativën më të drejtë dhe kjo ka qenë alternativa e bisedimeve për ta tejkaluar gjendjen e krijuar në atë pjesë të vendit. Sa i përket zhbërjes së strukturave paralele, tha se ato janë zhbërë në ato fusha ku janë arritur marrëveshjet, duke shtuar se edhe para arritjes së marrëveshjeve, disa nga ato janë shuar, siç janë ato të doganave dhe vulave paralele, të policisë paralele serbe dhe se 4 komunat veriore, pas zgjedhjeve të vitit 2013, tashmë punojnë me ligjet e Kosovës.

Raporti i publikuar flet për të gjithë procesin, ndërsa takimet në Bruksel kanë të bëjnë me një raund bisedimesh, ka mundësi që një takim ka qenë shumë i mirë, por pastaj Serbia edhe pse është zotuar në takim të zbatojë marrëveshjet, në realitet nuk i ka zbatuar, prandaj ato reflektojnë në raport. Njoftoi anëtarët se komunat veriore kanë hyrë në një bllokadë financiare, sepse Serbia ka penguar këto komuna që ta miratojnë buxhetin me tendencë që arsimi dhe shëndetësia të mos jenë në sistemin e Kosovës. Sa i përket diplomave tha se Serbia nuk ka bërë asgjë lidhur me këtë çështje, e kemi njoftuar Brukselin, mirëpo më shumë se kaq nuk mund të bëjmë, sepse është një proces që varet nga 3 palët. Ministrja Tahiri tha se temat për të ardhmen në dialog do të jenë reparacionet e luftës, çështja e suksesionit, çështja e dhunimit të grave gjatë luftës, kompensimet e ndryshme për vrasje zhdukje, lëndime e tortura, që parashihen në të drejtën ndërkombëtare, duke shtuar se të gjitha këto i janë dorëzuar Brukselit në një dokument, në mars të vitit të kaluar.

Lidhur me barrikadën, ministrja Tahiri tha se është arritur marrëveshja në Bruksel, me të cilën autorizohet BE-ja që ta largojë atë. BE-ja ka premtuar që brenda 3 muajve do ta finalizojë planin e re-vitalizimit të urës, me të cilën hiqet edhe barrikada. Sa i përket fusnotës, tha se ajo është pranuar që 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, të mos përbëjnë bllokadë në rrugën e avancimit të Kosovës drejt integritetit evropian, jo se e ka kërkuar Serbia, ndërsa këto 5 vende e kanë mbështetur MSA-në për Kosovën dhe se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të ndikojë edhe në shtimin e numrit të njohjeve.

Lidhur me peticionin tha se i është drejtuar përfaqësueses Speciale të OKB-së për çështjet e dhunimit të grave gjatë luftërave, nga e cila ka marrë përgjigje se raporti i kërkuar të përgatitet nga OKB-ja mund të bëhet edhe nga institucionet e Kosovës. Duke u mbështetur në rezolutën e miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së për mbrojtjen e kësaj kategorie të grave, tha se janë duke e përgatitur përgjigjen me argumentin se ne kemi kërkuar që OKB-ja ta përgatisë këtë raport, pasi që e ka edhe obligim ligjor.

Çështja e të pagjeturve ka qenë në dialogun e Brukselit, nuk ka vazhduar tutje, por është shtruar për agjendë me znj. Mogherini, duke shtuar se synimi i ynë është që BE-ja të emërojë një emisar special për zgjidhje sa më të shpejtë të kësaj tragjedie.

Blerta Deliu-Kodra, duke iu referuar përgjigjes së ministres Tahiri, përkitazi me peticionin, tha se synimi i qytetarëve të Kosovës ka qenë që të bëhet një raport ndërkombëtar dhe të ketë drejtësi ndërkombëtare. Kërkoj që të vazhdohet presioni ndaj këtij fenomeni.

Puhie Demaku, pajtohet me ministren Tahiri se dialogu është obligim ndërkombëtar, por shtoi se në rezolutë nuk thuhet se nuk mund të kushtëzohet dialogu, dhe se dialogu ka mundur të organizohet në një mënyrë tjetër me një agjendë të përpiluar më drejt, në bashkëpunim me Kuvendin dhe me një transparencë më të madhe. Edhe përkundër kushtëzimeve të vendosura nga BE-ja për Serbinë, tha se Serbia e ka statusin e vendit kandidat, kurse në MSA, Kosova paraqitet si etnitet jo-shtetëror. Shtroi pyetjen: a mund të kushtëzohet Serbia me raundin e ri të bisedimeve, me implementim të marrëveshjeve, meqë marrëveshjet janë arritur? Sa i përket barrikadave, pyeti: Pse involvohet BE-ja, kur më herët është thënë se do të veprohet sipas ligjeve të Kosovës? Gjithashtu, kërkoj nga ministrja Tahiri të komentohet deklarata e Jabllanoviqit.

Edita Tahiri, tha se për largimin e barrikadës qasja institucionale ka qenë në koordinim me partnerët si BE-ja dhe Ambasada e SHBA-ve dhe se i kemi dhënë porosinë BE-së që nëse vonohet në këtë çështje, ne do ta përdorim ligjin. Lidhur me MSA-në, tha se sipas ligjeve të BE-së, MSA-ja u jepet vetëm shteteve. Serbia e ka një prioritet në raport me Kosovën, statusin e kandidatit, por dinamikat e nisjes së këtij procesi kanë qenë të ndryshme për të dyja shtetet. Duke iu referuar pyetjes së deputetes Demaku për kushtëzime për dialogun ndaj Serbisë tha se strategjia jonë ka qenë të mos përdorim taktika të natyrës teknike, por taktika strategjike, duke i vënë vijat e kuqe në platformën e dialogut, këto vija janë edhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës. Sa i përket deklaratave të Jabllanoviqit, tha se ai është shkarkuar dhe nuk ka çfarë të thuhet tjetër. Ministrja Tahiri shtoi se ka ndryshuar situata në pjesën veriore pas dialogut, sidomos në kufirin ndërshtetëror, dhe se zyrtarët e Serbisë duhet të marrin leje nga shteti i Kosovës për të hyrë në Kosovë.

Ismet Beqiri, tha se ka nevojë që deputetët dhe opinioni i gjerë të informohen për gjithë ato që kanë ndodhur në dialog. Tha se dialogu nënkupton kompromis të dhimbshëm, por jo në përmasa të tilla që i bën dëm vendit dhe duhet ta kuptojmë se nuk jemi ne ata që mund të diktojmë në çdo gjë. Më tej, shtoi se dialogu duhet të kornizohet në tema dhe në kohë, sepse nuk duhet të jetë i pakufi, pra duhet të ketë një këmbëngulje më të madhe në implementim të marrëveshjeve.

Enver Hoxhaj, tha se shqetësimet e përbashkëta kanë të bëjnë me pjesën e implementimit, ku duhet të ketë më shumë vëmendje, por se shqetësimi im si deputet ka të bëjë me atë se si ne të kalojmë në një fazë të re. Qëllimi i fazës së parë ka qenë të nxjerrim Serbinë prej 4 komunave në veri, tash duhet të ketë më shumë tema bilaterale e më pak të brendshme. Sa i përket demarkacionit kufirit, tha se në relacion me kaptinën 23 dhe 24, që merren me çështjen e territorit dhe të popullatës, duhet të dalim me një agjendë që përkon me parametrat e agjendës integruese evropiane karshi Serbisë.

Shprehu mendimin se para njohjes reciproke dhe krijimit të marrëdhënieve diplomatike me Serbinë, duhet ta kemi një situatë ku Kosovës i mundësohet anëtarësimi në OKB, OSBE dhe organizata tjera

që i referohen sovranitetit dhe që në këtë kuptim duhet të dilet me një koncept të afatizimit të dialogut, jo në kuptimin e muajve, por të thuhet se çfarë mund të arrijmë në tri vitet e ardhshme.

Kryetari tha se me marrëveshjet e arritura nuk është prekur asnjë ligj dhe as Kushtetuta, por janë arritur marrëveshje të natyrës politike. Kjo flet për atë se nuk ka pasur lëshime të mëdha dhe shtroi pyetjen se çfarë mund Komisioni të ndihmojë në procesin e dialogut.

Edita Tahiri, sa i përket bashkëpunimit, mund të jetë i disa niveleve, pjesëmarrja e deputetëve në raundet e bisedimeve, këmbimit të ideve dhe hartimit të një koncepti strategjik.

4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës

Enver Hoxhaj, theksoi se bazuar në legjislacionin në fuqi, Komisioni ka për detyrë të mbikëqyrë punën e Qeverisë, e edhe në Planin e punës së Komisionit është paraparë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Pas diskutimit, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, në përbërje:

1. Puhie Demaku, kryesuese e grupit punues;
2. Teuta Rugova, anëtare e grupit punues;
3. Blerta Deliu- Kodra, anëtare e grupit punues;
4. Qerim Bajrami, anëtar i grupit punues;
5. Zafir Berisha, anëtar i grupit punues.

5. Njoftim rreth bashkëpunimit parlamentar

Enver Hoxhaj i njoftoi anëtarët e Komisionit se i janë bërë disa shkresa vendeve të ndryshme për realizime të vizitave zyrtare nga Komisioni ynë dhe prej disa shteteve kemi marrë përgjigje. Shkresave të Komisionit i është përgjigjur Çekia, Luksemburgu, Malta Estonia, Danimarka Japonia, Sllovenia, Kroacia e Bullgaria. Ai propozoi që për realizimin e vizitave, secili anëtar i Komisionit të vendosë se në cilën vizitë do të shkojë, të bëhet ndarja në grupe dhe të kërkohet nga Kryesia, mbështetje për realizimin e këtyre vizitave zyrtare. Kryetari i Komisionit shtroi çështjen e mungesës së një anëtar i Komisionit nga komuniteti serb, për të cilën tha se paraqet shumë peshë për vizita të tilla dhe kërkoi mbështetje të Komisionit për të bërë kërkesë, që në përbërjen e Komisionit, të jetë edhe një anëtar i komunitetit serb.

Puhie Demaku, propozoi shpërndarjen e një dokumenti të Strategjisë për bashkëpunim parlamentar të punuar nga NDI-ja, që të jetë objekt shqyrtimi në Komision, si dhe ngriti çështjen e vizitës së Komisionit në Shqipëri.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të hartohet kërkesa e Komisionit për realizimin e vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

6. Të ndryshme

Enver Hoxhaj, bëri të ditur se Programi i Qeverisë, i është përcjellë Kuvendit dhe propozoi që pas shqyrtimit të tij në Kuvend, të shqyrtohet edhe në Komision dhe të shikohet se cilat pika nga programi mund të integrohen në Planin e punës së Komisionit.

Lidhur me çështjen e ngritur për vizitën e kryetarit të Komisionit në Izrael, kryetari njoftoi se vizitën e ka realizuar në cilësi të deputetit dhe të ish- ministrit të Jashtëm, me ftesë të Këshillit të Izraelit për Marrëdhënie me Jashtë. Në këtë cilësi, ai njoftoi se ka edhe ftesa të tjera për vizita, si në Pakistan, Egjipt etj.

Anëtarët e Komisionit, lidhur me vizitat zyrtare të kryetarit jashtë vendit, në cilëndo cilësi që ai i bën, thanë se duhet të prezantohet edhe në cilësi të kryetarit të Komisionit, sepse i bën nder Komisionit, por kërkuan që në mungesë të tij, të njoftojë nënkryetaren për mbajtjen e takimeve të Komisionit, nëse është e nevojshme.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj